


Dr. Musli Vërbani

Kurbani



Kaçanik




Dr. Musli Vërbani

K U R B A N I

**I UD'HIJES, I HEDJIT, NEDHRIT,
AKIKIT DHE I VASIJETIT**

Kaçanik, 2008



Autori:
Dr. Musli VËRBANI

Titulli:
KURBANI
I HEDJIT, NEDHRIT, AKIKIT DHE I VASIJETIT

Korrektura:
Daut Shehu

Fotot dhe Ballina:
Izet Krivenjeva

Radhitja kompjuterike:
Mumin Shehu

Prishtinë
2008

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi



KURBANI

Fjala “Kurban” është fjalë me prejardhje arabe dhe rrjedh nga folja “ قَرَّبَ (karrebe) – يُقَرِّبُ (jugarribu)”, që do të thotë “*afrim*”. Mirëpo, në rastin konkret ka të bëjë me *sakrificë*, e cila të afron te Allahu i Madhërishëm. Pra, Kurban do të thotë sakrifikim apo gatishmëri për të sakrifikuar çdo gjë, po edhe në qoftë se është në pyetje jeta, vetëm e vetëm për të fituar gradën e nivelit më të lartë - *të afruarit te Allahu i Madhërishëm*.

Në islam kemi dy festa vjetore dhe që të dy festat janë të ndërlidhura me humanizëm, mirësjellje, tolerancë, butësi dhe paqe. Dhe që të dyja kanë të bëjnë me kontributin e muslimanit për të tjerët në praktikë, e jo në teori, sepse përkrahja morale ndaj të tjerëve duhet të realizohet në praktikë. Në Fitër Bajram përkrahja ndaj të tjerëve bëhet duke u dhënë mjete materiale, ndërsa në Kurban Bajram përkrahja ndaj të tjerëve bëhet duke sakrifikuar, e pastaj ajo sakrificë t’u jepet tjerëve, vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe të afruarit tek Ai.

Kurbani është bërë obligim (vaxhib) në vitin e dytë të hixhretit. Dhe kjo është e argumentuar me Kur’an, sunet dhe ixhma.

Argumentimi me Kur’an:

Në suretul Kevther Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ (1) فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ (2)

“Nuk ka dyshim, se Ne, ty (o Muhamed) ta kemi dhënë kevtherin (islamin, sheriatin, fjalën La ilahe il-lallah dhe ujin e posaçëm të xhenetit). Andaj, fale namazin (e Bajramit) dhe ther kurban”.

(El-Kevther, 1-2)





Po ashtu në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“(Thuaj) nuk ka dyshim se i tërë namazi im (dhe lutjet e mia), adhurimi (kurban) im, e tërë jeta ime, por edhe vdekja ime, thjesht është vetëm për Allahun – Zotin e të gjithë botëve”.

(El-En'amë, 162)

Ajetin tjetër, i cili tregon për dispozitimimin e kurbanit, e gjejmë në suretul Haxh:

وَالْبُذُنَ جَعَلْنَاهَا لَكُمْ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ لَكُمْ فِيهَا خَيْرٌ فَاذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهَا

صَوَافٍ فَإِذَا وَجَبَتْ جُنُوبُهَا فَكُلُوا مِنْهَا

وَأَطِيعُوا الْقَانِعَ وَالْمُعْتَرَّ كَذَلِكَ سَخَّرْنَاهَا لَكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“E devetë (të cilat bëhen kurban) jua kemi bërë prej dispozitave të Allahut, që prej atyre (dispozitave) keni dobi, andaj përmendeni emrin e Allahut, deri sa të jenë ato në këmbë (pa u therë), e kur të shtrihen në tokë (pasi t’i keni therë) hani prej tyre dhe ushqeni atë që lyp dhe atë që nuk lyp. Kështu, ato (kafshë) jua vëmë në shërbimin tuaj që të jeni mirënjohës.”

(El-Haxh, 36)

Qëllimi i kurbanit nuk është vetëm derdhja e gjakut dhe ngrënia e mishit, por me kurban simbolizohet gatishmëria për sakrificë, solidaritet, bamirësi, besim, sinqeritet dhe devotshmëri. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لَنْ يَنَالَ اللَّهُ لُحُومُهَا وَلَا دِمَاؤُهَا وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَى مِنْكُمْ كَذَلِكَ سَخَّرَهَا

لَكُمْ لِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَى مَا هَدَاكُمْ وَبَشِّرِ الْمُحْسِنِينَ

“Tek Allahu nuk arrin as mishi i atyre (kurbaneve) e as gjaku i tyre, por tek Ai (Allahu) arrin bindja dhe devotshmëria e juaj”.

(El-Haxh, 37)





Argumentimi me sunet:

Në librat e haditheve, pra në koleksionet e tyre, janë regjistruar shumë hadith që tregojnë për dispozitimin e kurbanit, por ne do t'i tregojmë disa prej tyre:

Hadithi:

“Veprën e parë që do ta bëjmë në këtë ditë të Bajramit është se do ta falim namazin e Bajramit, e pastaj do të kthehemi e do të presim kurbanet. Kush vepron kështu ka praktikuar sunetin tim”.

Nuk theret kurbanit para ditës së Bajramit, apo siç është bërë zakon tek ne që në natën e Bajramit (një ditë para Bajramit) të prehet kurbanit për të vdekurit. Por, kurbanit për të gjallët edhe për të vdekurit është paraparë të theret në ditën e parë, të dytë dhe të tretë të Bajramit. Ndryshe edhe ditët e haxhit, për këtë arsye edhe quhen ditët e therjes apo kurbanit (Ejjamun-Nahr).

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kush e ther (e pret) kurbanin para namazit të Bajramit le ta përsëritë kurbanin e tij (le ta therë tjetër), e kush e ther pas faljes së namazit (të Bajramit) ai e ka plotësuar obligimin e tij dhe e ka praktikuar sunetin e myslimanëve”.

Në një hadith tjetër Muhamedi s.a.v.s. thotë:

“Kur dikush nga ju dëshiron dhe pret kurban, një pjesë të atij (kurbanit) le ta ndalë për nevojat e veta”.

Po ashtu Aishja r.a. tregon se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Në kohën e ditëve të Kurban Bajramit, prej veprave më të dashura tek Allahu është se besimtari, i cili e pret kurbanin do të gëzohet me shpërblim të madh nga Allahu xh.sh. në jetën e posaçme, kur dihet se besimtari e ther kurbanin me qëllim që të fitojë kënaqësinë e Allahut, për të kryer këtë detyrë vetëm për shkak të urdhrat të Allahut. Nga ana tjetër kjo vepër e mirë do të arrijë tek Allahu, para se të bjerë pika e parë e gjakut në tokë. Prandaj, zbukuroni punët tuaja me kurbane”.





Argument nga ixhmait:

Janë pajtuar të gjithë dijetarët e umetit se kurhani është dispozitë dhe këtë nuk e ka kundërshtuar askush asnjëherë, andaj edhe merret si argument i ixhmait.





IBRAHIMI A.S. DHE KURBANI I XHENETIT

Ibrahimi a.s. e ka lutur Zotin e Madhërishëm:

رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ

“O Zoti im më dhuro mua (fëmijë) nga të mirët”.

(Es-Saffat, 100)


Kur e sheh dëshirën e flaktë të Ibrahimit a.s. që të ketë djalë të mirë, Allahu ia plotëson dëshirën, ia pranon lutjen dhe e përgëzon me djalë të urtë, të mençur, të dëgjueshëm dhe të sjellshëm. Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an, ku thotë:

فَبَشِّرْنَاهُ بِغُلَامٍ حَلِيمٍ

“Dhe Ne e përgëzuam atë me një djalë që do të jetë i urtë dhe i mençur”. *(Es-Saffat, 101)*

Këtë fëmijë Zoti i Lartmadhëruar ia fali pas 80 viteve.

Kur ky fëmijë arrin moshën që t'i ndihmonte, ta përkrahte babën e tij, mu atëherë Zoti, nëpërmjet ëndrrës, i bën me dije që këtë fëmijë duhet ta sakrifikojë dhe ta bëjë kurban vetëm për ta fituar kënaqësinë e Allahut. Testimi dhe sprovimi i Ibrahimit nuk ishte vetëm në këtë rast, ai i kishte kaluar të gjitha testet shkëlqyeshëm, tani ishte radha e testimit më të rëndë më të vështirë sa s'ka më. Ibrahim i ishte testuar dhe kishte rënë në sprovë atëherë kur i tërë populli (njerëzimi) ishte pabesimtar, ndërsa ai ishte i vetmi besimtar. Ai i dëbua nga babai i tij vetëm pse ishte besimtar, ai është hedhur në zjarr, ndërsa me gjakftohtësi thoshte “Hasbijallahu ve Niemel Vekilë” (Më mjafton Allahu, Ai është ndihmëtar i mirë), prandaj Zoti e ka shpëtuar. Ai ishte sprovuar edhe me mbretin tiran – Nemrudin, i cili ka tentuar t'ia çnjerëzonte gruan e tij, por edhe aty del ngadhënjimtar. Ai është privuar një kohë të gjatë nga





fëmijët, ai vazhdimisht është endur dhe ka migruar nga një vend në tjetrin. Ai qysh në momentin e lindjes së djalit e ka braktisur gruan dhe djalin e tij në mes të shkretëtirës në Meke. Dhe tani ishte testi i fundit – therja e djalit, pasi që edhe këtë testim e ka kaluar me të drejtë ai edhe e ka marrë gradën “Halilull-llah – *Dashamir i ngushtë i Allahut*”.

Kur Ibrahim i a.s. e sheh ëndrrën, e thërret birin e tij – Ismailin a.s. e i thotë:

... قَالَ يَا بُنَيَّ إِنِّي أَرَى الْمَنَامَ أَنِّي أَذْبَحُكَ فَانْظُرْ مَاذَا تَرَى ...

“O biri im! Vërtet, unë vazhdimisht po shoh ëndërr sikur unë po të theri (po të bëj kurban). Po ti, çfarë mendon?”.

Ismaili a.s. i thotë:


... قَالَ يَا أَبَتِ افْعَلْ مَا تُؤْمَرُ سَتَجِدُنِي إِنْ شَاءَ اللَّهُ مِنَ الصَّابِرِينَ .


“O babai im, vepro sipas asaj që je i urdhëruar. Në dashtë Allahu (edhe kur të më therësh) do ta shohësh se do të jem prurimtarëve”.

(*Es-Safat*, 102)

Pas konsultimit dhe vendimit të përbashkët të babait dhe të birit, Ibrahim i a.s. e merr Ismailin, e merr thikën, e mpreh mirë dhe niset për ta dërguar në vendin e therjes. Në këtë kohë shejtani me pamjen e një burri të moshuar dhe të urtë shkon te Ismaili dhe i thotë: “O Ismail! Babai yt është plakur dhe tani nuk logjikon si duhet dhe thotë gjëra të kota, dhe dëshiron të të therë pa kurrfarë shkakut e arsye. Ismaili, edhe pse ishte shumë i ri, merr shtatë guralecë dhe me ta e gjuan të moshuarin (shejtanin). Në këtë vend haxhilerët simbolikisht gjuajnë shejtanin në vendin e quajtur “Xhemretu Sugra – *Gjuajtja e guralecëve në vendin e vogël*”.

Shejtani kur e sheh se nuk mund ta bindë djalin – Ismailin a.s., shkon tek nëna e tij – Haxherja dhe i thotë: “Oj Haxhere! Shko dhe pengoje Ibrahimin se ai ka vendosur ta therë djalin tuaj të vetëm”. Haxherja, nëna që ishte e bindur thellë në





vullnetin e Zotit, merr shtatë guralecë dhe me ta gjuan shejtanin. Për ta përjetësuar këtë veprim është bërë traditë që haxhilerët të gjuajnë shtatë guralecë te vendi ku ka ndodhur Haxherja e që quhet “Xhemretul vusta – *Vendgjuajtja e guralecëve në vendin e mesëm*”.

Pastaj shejtani shkon te Ibrahim i a.s. e i thotë: “O Ibrahim! Si e lejon veten ta therësh djalin tënd të vetëm, vetëm për shkak të ëndrrave, a e di se ato janë iluzione. A e di se tani je tepër i moshuar e nuk mund të kesh fëmijë tjerë. Ibrahim i a.s. ishte i bindur thellë në Zotin, i ishte dorëzuar vullnetit të Zotit tërësisht, për këtë arsye edhe ai i merr shtatë guralecë dhe e gjuan shejtanin tek vendi që sot quhet “Xhemretul Kubra – *Vendgjuajtja e guralecëve në vendin e madh*”.

Përderisa Zoti ka bërë ligj që zjarri të djegë dhe të shkrumbojë gjithçka, te rasti i Ibrahimit, por edhe kur të dëshirojë Zoti, mund ta ndryshojë dhe ta bëjë që të mos djegë, por përkundrazi të freskojë. Po ashtu përderisa Zoti e ka bërë ligj që thika të pretë, Zoti mund ta ndryshojë atë ligj që thika të mos pretë. Kështu Ibrahim i a.s. habitet se si thika e tij nuk e priste qafën e djalit të tij – Ismailit. Ismaili e ndjente lëvizjet e thikës, por nuk ndjente dhembje, e i thoshte babait: “O baba ngjeshe mirë, mprehe mirë thikën”, edhe pse baba e mprehte mirë thikën dhe e ngjeshte në qafën e të birit, ajo nuk e priste djalin. Zoti i Lartmadhëruar tregon në Kur’an:

فَلَمَّا أَسْلَمَا وَتَلَّهُ لِلْجَبِينِ (103) وَنَادَيْنَاهُ أَنْ يَا إِبْرَاهِيمُ (104)

قَدْ صَدَّقْتَ الرُّؤْيَا إِنَّا كَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ (105)

إِنَّ هَذَا لَهُوَ الْبَلَاءُ الْمُبِينُ (106) وَفَدَيْنَاهُ بِذَبْحٍ عَظِيمٍ (107)

“Dhe kur të dy iu dorëzuan urdhrin të Zotit dhe e përmbysi atë me fytyrë (për toke). Ne e thirrëm atë: “O Ibrahim! Ti tashmë e zbatove ëndrrën. Ne kështu i





shpërblejmë të mirët. Vërtet, kjo ishte sprovë e qartë. Ne e shpaguam atë me një kurban të madh”. (Es-Saffat: 103 – 107)

Ajo që ka ndodhur është se Xhibrili a.s. ia ka sjellë Ibrahimit a.s. një dash të madh, të bardhë dhe me brirë nga qielli, një dash nga xheneti. Thotë Ibn Abasi r.a.: “Ishte një dash, i cili kishte kullotur në xhenet për 40 vite. Ai kishte pirë ujë nga lumenjtë që burojnë prej Firdevsit të lartë”.

KUSHTET E THERJES SË KURBANIT

Për të qenë vaxhib kurban, personi në fjalë duhet t’i ketë të plotësuar këto kushte:

1. **Të jetë musliman**, që do të thotë se jomuslimani nuk mund ta presë kurbanin, por nëse e pret, nuk i pranohet;
2. **Të mos jetë rob**, pasi që dihet se rob i nuk ka të drejtë pasurie;
3. **Të mos jetë udhëtar** (sipas sheriatit islam), mirëpo nëse udhëtari e ther kurbanin, i pranohet, mirëpo ai kurban për të është kurban nafile (vullnetar), e jo pse e ka vaxhib. Ebu Bekri dhe Omeri r.a. nuk kanë prerë kurban kur kanë qenë udhëtarë.
4. **Të jetë i pasur apo të ketë mundësi materiale**. Për të qenë zekati farz, shuma e nisabit 92.5 gr. ari, apo kundërvlera e tij duhet të jetë në disponim të personit një vit të plotë, ndërsa me rastin e kurbanit personit të cilit gjatë ditëve të Kurban Bajramit i gjenden 92.5 gr. ari apo kundërvlera e tyre, dhe përpos kësaj shume mbulimi i nevojave elementare për jetë. Nëse i varfëri, i cili nuk e ka plotësuar këtë kusht e pret kurbanin, i pranohet, por kurban i tij është nafile (vullnetar) e jo vaxhib. Këtij personi i bëhet vaxhib nëse e blen kurbanin, por ndodh





që i humb, atij atëherë i bëhet vaxhib, edhe pse për të parën herë nuk e ka pasur vaxhib.

- Në shariat islam, burri nuk e ka vaxhib të presë kurban për gruan e tij, por nëse e pret i pranohet dhe ai kurban është vullnetar. Mirëpo nëse edhe burri edhe gruaja, secili prej tyre posedon pasurinë (shumën e sipërpërmendur), atëherë që të dy e kanë vaxhib therjen e kurbanit.


5. Të jetë i shëndoshë mentalisht.

Me rastin e Sadakatul Fitrit, fitrat jepen për çdo anëtar të familjes, ndërsa me rastin e kurbanit çështja nuk është kështu, që do të thotë nuk prehet kurban për çdo anëtar të familjes. Në anën tjetër nuk është vaxhib të prehet kurban për prindin apo familjarin e vdekur (e kurrresi që për të vdekurit të theret natën e Kurban Bajramit, e për të gjallët ditën e Kurban Bajramit) Me këtë nuk kemi për qëllim që të themi nuk prehet kurban për vdekurit, por përkundrazi i vdekuri, i cili para vdekjes ka lënë porosi (vasijet) që t'i prehet kurban, ai vasijet (porosi) patjetër duhet t'i plotësohet dhe të prehet kurban për të në ditën e Kurban Bajramit, e jo natën e Bajramit, dhe mishi i atij kurban në tërësi të shpërndahet.

Nga kjo që thamë mund të përfundojmë:

- Për të vdekurin, i cili ka lënë porosi (vasijet) vaxhib është prerja e kurbanit për të;
- Për të vdekurin, i cili nuk ka lënë porosi (vasijet) edhe nëse prehet kurban për të, është vaxhib kurban për personin i cili i pret kurbanin për prindin e tij apo për të afërmin e tij të vdekur, që do të thotë se nga vaxhibi nuk lirohet dhe duhet t'i presë dy kurbane;
- Kurban i edhe për të gjallët edhe për të vdekurit pritët prej ditës së parë e deri në ditën e tretë të Kurban Bajramit.





6. I moshërrituri

I moshërrituri lejohet që nga pasuria e të voglit, i cili ende nuk e ka arritur moshën e pjekurisë, që për të të pritët kurban, këtë e bën kujdestari i tij. E vërteta është se ai nuk e ka vaxhib, por është mustehab, pra e parapëlqyer kurban i për të voglin. Ndërsa babai nuk pret kurban për të voglin, sikurse e jep sadakatul fitrin edhe për të voglin.

Shart është nijeti. Prerja e kafshës mundet të jetë për mish, por edhe për afrim tek Allahu. Për këtë arsye shart është nijeti se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit”.

Nëse shtatë veta e prejnë një lopë kurban, atëherë që të gjithë pjesëmarrësit duhet ta kenë qëllimin për kurban, nëse njëri prej tyre nuk e ka nijetin për kurban, kurban i është i pavlefshëm për të gjithë, sepse afrimi (ibadeti) është në derdhjen e gjakut, e kjo nuk është arritur pasi njëri ka pasur qëllim tjetër.





KUSHTET QË DUHET T'I PLOTËSOJË KAFSHA PËR KURBAN

1. Që të jetë bagëti: dhi, dele, lopë, buallicë dhe deve. Dhitë e egra apo lopët e egra nuk lejohet të prehen si kurban. Edhe pse mishi i kafshëve të egra, si i dhisë së egër, i kaprollit – lejohet të hahet, nuk lejohen të prehen kurban, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ جَعَلْنَا مَنْسَكًا لِّيَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَىٰ مَا رَزَقَهُمْ مِنْ بَهِيمَةِ الْأَنْعَامِ
فَالِهَكُمْ إِلَهٌ وَاحِدٌ فَلَهُ أَسْلِمُوا وَبَشِّرِ الْمُخْبِتِينَ

“Ne i kemi caktuar çdo populli vendtherjen (e kurbanit), që ta përmendin emrin e All-llahut, për arsye se i furnizoi ata me kafshët. Zoti juaj është një Zot, andaj vetëm Atij dorëzohuni, e përgëzo të dëgjueshmit”.

(El-Haxh, 34)

Po ashtu nuk kemi dëgjuar se ndonjë prej sahabëve ka prerë kurban prej kafshëve të egra.

2. Që kurbanit të arrijë moshën e caktuar dhe të paraparë:
 - Delja dhe dhia duhet t'i kenë një vit të plotë e më shumë;
 - Lopa dhe buallica duhet t'i kenë dy vite e më shumë;
 - Deveja duhet t'i ketë pesë vite e më shumë.





ÇKA LEJOHET TË PREHET PËR KURBAN

1. Deveja pesë vjetësh;
2. Lopa dy vjetësh;
3. Buallica dy vjetësh;
4. Qengji dash mbi gjashtë muaj që ka mish si delja një vjetësh;
5. Dhia një vjetësh;
6. Bagëtinë e cila nuk ka brirë nga lindja;
7. Bagëtia që nuk e ka një pjesë të bririt;
8. Kafsha e tredhur, por më mirë është të mos jetë e tredhur.

KAFSHA QË NUK LEJOHET TË PREHET KURBAN

1. Kafsha e egër;
2. E verbëta në të dy sytë;
3. E verbëta në një sy;
4. E çala, e cila nuk mund të ecë deri te vendi i therjes;
5. Kafsha shumë e ligisht;
6. Kafsha, e cila e ka të humbur më shumë se gjysmën e veshit të saj;
7. Kafsha, e cila e ka të humbur më shumë se gjysmën e bishtit të saj;
8. Kafsha, së cilës i mungojnë më shumë se gjysma e dhëmbëve të saj;
9. Kafsha e lindur pa veshë;





10. Kafsha, e cila i ka humbur majat e sisëve.

KAFSHA E CILA ËSHTË MEKRUH TË PREHET KURBAN

Kafshët të cilat janë mekruh të prehen janë:

1. Kafsha me veshë të shqyer;
2. Kafsha me vesh të shpuar;
3. Kafsha me një pjesë të bishtit të këputur;
4. Kafsha e qethur.

Kurbani më i vlefshëm është kurban i deve, pastaj lopë, pastaj dash, e pastaj cjan. Kjo nëse kafshët kanë sasi të mishit të njëjtë, fjala vjen mishi i devesë për shtatë persona është 350 kg., ndërsa edhe lopa ka sasinë e mishit 350 kg dhe po ashtu shtatë dele, apo shtatë dhi kanë 350 kg, dhe po ashtu shtatë dele apo shtatë dhi kanë 350 kg., mirëpo nëse kafshët e vogla kanë më shumë se 350 kg. më e vlefshme është mishi i tyre, sepse qëllimi i kurbanit është të ushqyerit e numrit sa më të madh të të varfërve.

Assesi nuk lejohet të paguhet kundërvlera në vend të prerjes së kurbanit, siç është rasti i sadekatul fitrit, ku në vend të hurmave apo elbit, të jepet kundërvlera e tyre në të holla.

Nëse prehet kafsha për kurban dhe rastësisht vërtetohet se ka qenë mbarsë dhe kafsha e vogël shpëton, atëherë për kundërvlerë të saj jepet sadaka dhe kafsha e vogël rritet dhe shfrytëzohet.





DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR KURBANIN

- Ai i cili e ka vaxhib kurbanin dhe nuk e ka therë në tri ditët e Kurban Bajramit duhet ta blejë një kafshë dhe ta japë sadaka ose të japë sadaka kundërvlerën e kurbanit.

- Ai i cili e ka blerë, por për shkak të rrethanave të ndryshme nuk ka mund ta presë, kurbanin e jep sadaka të gjallë ose ta therë dhe tërë mishin ta japë sadaka.

- Nëse ndonjë person e ka blerë kurbanin, por i ka humbur ose i është vjedhur, ai e blen tjetrin, por nëse e gjen të parin brenda ditëve të bajramit ende pa e prerë, ai zgjedh cilin nga ata dy kurbane ta presë.

- I varfri, i cili nuk e ka vaxhib kurbanin, por ai vendos dhe e blen, por ndërkohë i humb, atij i bëhet vaxhib ta blejë një tjetër kurban dhe ta presë për kurban.

- Lejohet të autorizohet tjetri për të prerë kurban.
- Nuk lejohet të shitet asgjë nga kurban.

PËR SA PERSONA PREHET KURBANI

1. Delja dhe dhia janë kurban për një person;
2. Lopa, buallica dhe deveja për shtatë persona. Xhabiri r.a. ka thënë: *“E kemi kryer haxhin me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe e kemi therë një deve për shtatë vetë”*. (Transmeton Ahmedi dhe Muslimi)

- Kafsha e shtatë personave duhet të jetë i lidhur nijeti i të gjithëve për kurban, që do të thotë se nëse njëri pjesëmarrës në therje nuk ka për qëllim kurban, por vetëm për mish të rëndomtë, e jo të kurbanit, nuk u





lejohet gjashtë tjerëve për kurban. Kurban i tillë nuk vlen për asnjërin.

KOHA E THERJES SË KURBANIT

Gjatë tri ditëve të Kurban Bajramit bëhet prerja e kurbanit. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لِيَشْهَدُوا مَنَافِعَ لَهُمْ وَيَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ فِي أَيَّامٍ مَّعْلُومَاتٍ عَلَىٰ مَا رَزَقَهُمْ مِنْ
بِهِمَةِ الْأَنْعَامِ فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطْعِمُوا الْبَائِسَ الْفَقِيرَ


“(Vijnë) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin All-llahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra prej tyre (kurbaneve) dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfërin”.

(El-Haxh, 28)

Muhsiri i haxhit e pretë kurbanin hedj vetëm në ditët e Kurban Bajramit, ndërsa Muhsiri hedj i umres e pretë kur të dëshirojë gjatë tërë vitit.

SHPËRNDARJA E MISHIT TË KURBANIT

- Më së miri është që i gjithë kurban i të shpërndahet, por lejohet që edhe i tërë mishi të mbahet për vete dhe familjen e tij.
- Është e parapëlqyer që të ndahet në tri pjesë:
 - a. një pjesë t’u ndahet të varfërve,
 - b. një pjesë t’u ndahet të afërmeve dhe fqinjëve,
 - c. një pjesë të ndahet për familjen e tij.





- Lëkura e kurbanit nuk lejohet të shitet, por jepet sadaka, po ashtu therësi nuk lejohet të paguhet me lëkurën si dëmshpërblim të therjes apo me mish të kurbanit.

KUSH DUHET TA REALIZOJË PRERJEN E KURBANIT

Personi, i cili e ka vaxhib prerjen e kurbanit, më së miri është ta realizojë prerjen personalisht.

Transmetohet se Pejgamberi s.a.v.s. në Haxhin Lamtumirës ka vendosur t'i therë 100 deve kurban, prej tyre gjashtëdhjetë e disa i ka prerë me dorën e tij, ndërsa për të tjerat e ka autorizuar Alijun r.a.

Nëse ndokush nuk di apo nuk mundet, mirë është që së paku të prezantojë me rastin e therjes së kurbanit, sepse Muhamedi s.a.v.s. e ka këshilluar bijën e vet – Fatimen: “Oj Fatime, shko dhe prezanto në vendin ku prehet kurban për ty, për arsye se sapo të ndahet pika e parë e gjakut të kurbanit tënd, Allahu ka për t'i falur mëkatet.

Nëse ndokush nuk ka mundësi të prezantojë, atëherë nuk prish punë që këtë ta realizojë personi të cilin e ka autorizuar. Sa i përket të sakrifikuarit të kafshëve mund të jetë: të therurit e tyre që quhet **nahr** dhe të prerët e tyre që quhet **dhibh-h**.

Therja (nahri) është për kafshën qafëgjatë, siç është deveja, ndërsa **prerja** (dhibhi) është për kafshët qafëshkurtra, siç janë: lopët, delet, dhitë dhe buallicat.





PARA PRERJES SË KURBANIT


Kush e dërgon devenë deri te vendi i therjes, nëse është i detyruar të hipë në të, hipën, e nëse nuk ka nevojë të hipë në deve, nuk hipën deri te vendi i therjes, sepse atë e ka ekskluzivisht të pastër vetëm për Allahun. Përpos nëse e kërkon nevoja, siç ka qenë rasti kur Pejgamberi s.a.v.s. e ka parë një njeri të dobët dhe të paaftë duke e dërguar devenë deri te vendtherja, e i thotë: *“Hip në të”*.

Nëse lopa apo delja kanë qumësht, nuk milen, nëse është në pyetje pak para ditës së Bajramit; por nëse ka ende shumë ditë para ditës së Bajramit, milen lopët e delet, por qumështi i tyre, i tëri, jepet sadaka ose kundërvlera e qumështi të tyre jepet sadaka.

Aliu r.a. ka thënë: *“Jepe sadaka lëkurën dhe mos i jep kasapit asgjë prej saj (por paguaje posaçërisht)”*.

SI DUHET VEPRUAR ME RASTIN E PRERJES SË KURBANIT

Para se të prehet kurbanit është e parapëlqyer të merret abdest, të falen dy rekate nafile namaz (këto dy rekate nafile mund të falen edhe pas prerjes së kurbanit). Pastaj përcillet kurbanit deri te vendi i prerjes. Mjeti i prerjes duhet të jetë sa më shumë i mprehtë, me qëllim që prerja të bëhet sa më e shpejtë dhe kafshës mos t'i shkaktohen mundime, sepse Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:





“Kur t’i preni kafshët, preni ashtu që të jetë më së lehti, më së shpejti dhe më së miri”.

Nuk është mirë që mjeti të mprihet në prezencën e kafshës.

Pas kësaj kurban i rrëzohet në krah të majtë, nëse ka mundësi të kthehet në drejtim të kibles (Qabes), i lidhen tri, eventualisht të katërt këmbët, e me dorën e majtë i kapet koka, ndërsa me dorën e djathtë bëhet prerja. Para prerjes bëhet kjo lutje:

“Vexhehtu vexhhije lil-ledhi feteras-semavati vel-erda ve ma ene minel mushrikinë. Inne salatij ve nusukij ve mehjaje vel memati lil-lahi rabbil alemijne. La sherike lehu ve bidhalike umirtu ve ene evvelul muslimine. Allahumme minke ve leke an-nij ve ehli Muhamedin ve umetihî”.

Kjo lutje në gjuhën shqipe do të thotë:


“Fytyrën (personalitetin) tim e kam orientuar dhe drejtuar te Ai, i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën, e unë assesi nuk jam prej idhujtarëve. Nuk ka dyshim se namazi im, kurban i (dhe dhurimi im), po ashtu e tërë jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Krijues të gjithë botëve. Atij, nuk lejohet t’i bëhet idhujtari, e për këtë jam i urdhëruar dhe unë jam prej të parëve i cili dorëzohem dhe jam musliman. O Zoti im, prej Teje dhe për Ty, këtë kurban e theri me nijet për veten time (nëse është në pyetje për dikë tjetër, për filanin) dhe për familjen e Muhamedit dhe për umetin e tij”.





MJEKËSIA PËR THERJEN E BAGËTIVE

Kafshët e vogla, siç janë delja dhe dhia, për shkak se janë të imta, në ditën e sotme kasapët i presin drejtpërsëdrejti në fyt. Ndërsa kur është në pyetje ndonjë mëzat i madh apo lopë e madhe e dëmtojnë palcën kurrizore duke i futur prapa koke thikën e pasi të rrëzohet i pritët fyti i saj. Pastaj kur shitet, në shikim të parë duket se në të dy rastet mishi është i të njëjtës cilësi, por në fakt nuk është ashtu. Për ta kuptuar më lehtë, do të shohim se ç'janë sistemi i gjakut (vaskular) dhe sistemi nervor qendror (SNQ). Të gjithë e dimë se gjaku nuk është thjesht një lëng i zakonshëm me ngjyrë të kuqe, porse është një lëng plot jetë. Gjaku normalisht shërben për transportimin e oksigjenit nga mushkëritë nëpër të tërë indet e trupit tonë. Nëpërmjet gjakut bëhet edhe transportimi i lëndëve ushqyese nga pjesa tretëse nëpër organizëm si dhe lëndë të tjera me rëndësi specifike për organizmin. Në gjak ndodhen edhe eritrocitet (rruazat e kuqe) dhe leukocitet, të cilat në gjuhën popullore njihen edhe si rruazat e bardha dhe që kanë funksione specifike mbrojtëse për organizmin. Gjatë çdo sëmundjeje me anë të gjakut përhapen mikroorganizma të ndryshme, bakterie dhe viruse. Roli i rruazave të bardha është pikërisht eliminimi i tyre nga organizmi ynë. Por, nga ana mjekësore njihen edhe gjendje të veçanta të quajtura bakteremi apo viroza kur gjaku bëhet transportuesi i këtyre mikroorganizmave dhe trupi ynë nuk shfaq sëmundje. Edhe në këtë rast roli i leukociteve (rruazave të bardha) është thelbësor në pastrimin e gjakut të tërë organizmit. Shprehja popullore “Uji që s’lëviz qelbet” vlen edhe për gjakun. Nëse do të marrim rastin kur gjaku del nga enët ku ai lëviz ose





ndalon së lëvizuri në sistemin vaskular, atëherë ai i humb vetitë e tij mbajtëse dhe kthehet në të kundërtën e tij, një ushqim për mikroorganizmat e ndryshëm që qarkullonin nëpër të dhe një burim rreziku real. Le të sqarojmë diçka shkurtazi edhe për SNQ-në (Sistemi Nervor Qendror). Është një pjesë e SNQ-së që në gjuhën mjekësore quhet Sistemi Nervor Autonom, i cili kryen të gjitha funksionet që janë jashtë ndërgjegjes tonë. Gjithkush prej nesh e ka provuar se si pas një emocioni të fortë, të rrahurat e zemrës rriten jashtë dëshirës sonë dhe po ashtu shumë lëvizje instiktive kryhen pavarësisht nga dëshira apo kontrolli ynë. Për të gjitha këto e shumë procese të tjera përgjigjet pikërisht Sistemi Qendror Autonom. Ky sistem në vetvete ndahet në dy pjesë që emërohen si simpatiku dhe parasimpatikus. Të dyja pjesët inervojnë (përhapen) në të gjitha organet e trupit dhe në përgjithësi kanë funksione të kundërta në këto organe. Kështu në sistemin vaskular parasimpatikus bën zgjerimin e enëve të gjakut, ndërsa simpatiku bën ngushtimin e tyre. Simpatiku njihet edhe ndryshe si veprues gjatë stresit dhe qendrat e tij nervore ndodhen në palcën e kurrizit, në pjesën torakale (të gjoksit) dhe lumbare (të shpinës) dhe kanë lidhje të ngushta me trurin e madh me anë të fijeve të shumta nervore.

Pas këtyre shpjegimeve të domosdoshme le të kthehemi në çastin e therjes. Therja vetëm me anë të prerjes në fyt siç na ka treguar Profeti s.a.v.s., dhe ashtu si urdhëron Allahu i Lartmadhëruar në Kur'an për lloje të kafshëve të lejuara:

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةُ وَالْدَّمُ وَلَحْمُ الْخِنْزِيرِ وَمَا أَهَلَ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ وَالْمُنْخَنِقَةُ
وَالْمَوْقُوذَةُ وَالْمُتَرَدِّيَةُ وَالنَّطِيحَةُ

وَمَا أَكَلَ السَّبُعُ إِلَّا مَا ذَكَّيْتُمْ وَمَا ذُبِحَ عَلَى النُّصَبِ

“Juve u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësira, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emrin e Allahut, e furmja, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara (nga briri i tjetrës), ajo që







e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therni (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhuj dhe (u është ndaluar) të kërkonit me short fatin ...”.

(El-Maide, 3)

Në çastin kur i pritët fyti, kafshës së bashku me gurmazin i priten edhe enët vaskulare që normalisht i furnizojnë me gjak trurin. Në këtë çast, i gjithë organizmi vihet në alarm dhe krijohet e ashtuquajtura gjendje stresi. Truri është në gjendje të jetojë pa gjak 3-5 minuta. Që në çastin e parë trurit i duhet të ruajë funksionet jetësore të tre organeve: Zemrës, mushkërive si dhe vetë trurit. Humbja e gjakut perceptohet si mungesë në furnizimin me gjak, prandaj për këtë arsye ai (truri) “urdhëron” përjashtimin nga furnizimi me gjak të të gjithë pjesëve të tjera trupit, përveç tre organeve që u përmendën më sipër. Këtë rol e kryen simpatiku. Ky i fundit bën vazokonstruksin ose ngushtimin e enëve të gjakut periferike, duke filluar sipas rëndësisë: lëkura, muskujt, organet e brendshme, si shpretka, aparati tretës (stomak, zorrë), veshka e deri te mëlçia. Kështu në mënyrë figurative mund të themi se bëhet një shtrydhje e gjakut nga këto organe, me qëllim që gjaku të shkojë në zemër. Vetë vazokonstruksi ndjek një radhë të caktuar, fillon me kapilarët që janë të trashë sa 1/15 e fijos së një floku, pastaj venulat e kështu me radhë deri në enët e mëdha të gjakut, venat. Ndërkohë që organet “shtrydhen” nga gjaku, i cili vazhdon të humb nëpërmjet enëve të prera të fytyrës, ndërkaq kafsha merr frymë thellë, sepse i duhet të bëjë oksigjenimin e trupit dhe për pasojë edhe të trurit. Në kafazin e kraharorit si rrjedhë e këtyre frymëmarrjeve, krijohet një presion negativ, i cili ndihmon që gjaku të kalojë nga venat e vogla dhe periferike në venat e mëdha dhe prej këtej në zemër. Kështu, pra, mushkëria luan rolin e një pompe në thithjen e gjakut. I gjithë ky proces vazhdon jo më gjatë se 3-5 minuta, aq kohë sa truri mund të qëndrojë në jetë pa u furnizuar me gjak,






porse kjo kohë është e mjaftueshme që trupi i kafshës të zbrazet nga gjaku.

Ç'ndodh kur prerja bëhet me dëmtim të shtyllës kurrizore?

Gjatë kësaj therjeje ndërpritet lidhja ndërmjet trurit të madh dhe simpatikut, gjithashtu trurit të madh dhe nervave që inervojnë muskujt e trupit që e marrin zanafillën në palcën kockore. Në këtë rast kafsha paralizohet dhe ndërpritet frymëmarrja si pasojë e paralizimit të muskujve brinjore dhe diafragmës përgjegjëse për aktin e frymëmarrjes. E lënë në këtë gjendje, edhe pa ju prerë fyti, do të ngordhë për 3-5 minuta. Me prerjen e fytit më pas, kafsha fillon të humbas gjak, por kjo sasi është më e pakët se në rastin e parë kur therja është bërë sipas rregullave të caktuara. Në këtë rast enët e gjakut, të cilat ngushtoheshin në rastin e parë, këtu dilatohen (zgjerohen), sepse nuk vepron më simpatiku si pasojë e prishjes së palcës kurrizore. Madje hapen edhe kapilarët rezervë që organizmi nuk i vë normalisht në funksion. Kjo bën që një pjesë e rëndësishme e gjakut të burgoset nëpër indet e ndryshme të organizmit. Të mos harrojmë, se e përmendëm qysh në fillim, që gjaku ishte shpeshherë mbajtës i mikroorganizmave të ndryshme të dëmshme dhe në çastin që pushon së qarkulluari nëpër enët e gjakut kthehet në ushqim për këto organizma. Gjithashtu një nga cilësitë e kafshës së ngordhur (ngordhësirave) është se mishi i saj është i mbushur me gjak! Nga ana tjetër zemra vazhdon të punojë, sepse ka një sistem autonom, por nuk ka më funksionin e pompës së mushkërisë, e cila nuk punon si pasojë e paralizimit të muskujve ndërbrinorë dhe diafragmës. Kështu që në këto raste kasapët për të nxjerrë gjakun detyrohen të shtypin barkun e kafshës.

Pra, me pak fjalë në rastin e dytë kafsha nxjerr më pak gjak dhe mishi i saj është i rrezikshëm për ushqim. Prandaj edhe therja sipas mënyrës së përcaktuar nga Pejgamberi s.a.v.s. është më e saktë nga ana shëndetësore. Kjo është edhe arsyeja që gjaku dhe





ngordhësit janë të ndaluara për t'i ngrënë, sepse mikroorganizmat që gjallojnë në trupin e kafshës, në gjak, pas ngordhjes së saj, janë një rrezik real për njeriun që e përdor atë lloj mishi.

LLOJET E KURBANIT

Varësisht nga ajo se për çfarë arsye pritet kurban, kurban është i shumëllojshëm:

1. Kurban UD-HIJE (i sakrificës);
2. Kurban HEDJ (i dhuratës në shenjë adhurimi);
3. Kurban NEDHËR (i përбетimit);
4. Kurban AKIKË (i mburojës);
5. Kurban i VASIJETIT (i porosisë).

1. KURBANI UD-HIJE (I SAKRIFICËS)

Kurbani Ud-Hije (i sakrificës) është dy llojesh:

1. Kurban ud-hije vaxhib dhe
2. Kurban ud-hije vullnetar-nafile.

1. **KURBANI UD-HIJE VAXHIB** është kurban për të cilin është i obliguar i pasuri, i cili e ka arritur shumën e nisabit të zekatit gjatë ditëve të Bajramit (përpos nevojave elementare jetësore).

Po ashtu në këtë lloj të kurbanit bën pjesë edhe kurban i të varfërit, të cilit i ka humbur kurban pasi që e ka blerë, edhe pse për të parën herë nuk e ka pasur vaxhib, por ai vet e ka ngarkuar veten me obligueshmëri.





Nëse kurban pas i prehet i gjendet kafsha e vogël në bark e gjallë, e shet atë të voglin e kafshës së therur, e jep shumën e asaj shitjeje sadaka, sepse nëna ka qenë e paraparë për kurban.

2. **KURBANI NAFILË** (vullnetar) është kurban i udhëtarit (sipas sheriatit islam) dhe i të varfrit, i cili me vullnetin e tij ka vendosur të therë një kurban, dhe që nuk është përbetuar më herët se do ta presë (për kurbanin e përbetimit do të flasim më vonë).

Edhe pse ky lloj i kurbanit është nafilë, që nga momenti i therjes kalon në dispozitën e vaxhibit.

Ebu Bekri dhe Omeri nuk kanë prerë kurban kur kanë qenë udhëtarë. Po ashtu edhe Aliju r.a. ka thënë:

“Udhëtari nuk prenë kurban dhe nuk e falë namazin e xhumasë”. Por edhe për shkak se udhëtimi në vetvete ka vështirësi - nuk është vaxhib kurban.

I moshërrituri lejohet që nga pasuria e të voglit, i cili ende nuk e ka arritur moshën e pjekurisë, që për të të prehet kurban, këtë e bën kujdestari i tij. E vërteta është se ai nuk e ka vaxhib, por është mustehab, pra është e parapëlqyer kurban për të voglin. Ndërsa babai nuk pret kurban për të voglin sikurse që e jep sadakatul fitrin edhe për të voglin.

Shart është nijeti. Prerja e kafshës mund të jetë për mish, por edhe për afrim tek Allahu. Për këtë arsye shart është nijeti, se Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit”***. Nëse shtatë veta e presin një lopë kurban, atëherë që të gjithë pjesëmarrësit duhet ta kenë qëllimin për kurban, nëse njëri prej tyre nuk e ka nijetin për kurban, kurban është i pavlefshëm për të gjithë, sepse afrimi (ibadeti) është në derdhjen e gjakut, e kjo nuk është arritur pasi njëri ka pasur qëllim tjetër.





2. KURBANI HEDJI (I DHURATËS)

Kurban hedj do të thotë kurban dhuratë. Ndërsa në sheriatin islam quhet kurban i të cilin e ther haxhiu gjatë kohës së haxhit. Ky lloj kurban i është posaçërisht për haxhilerët në kohën e haxhit. Ndryshe ky lloj kurban i quhet *kurban i demit* (i gjakut) dhe *kurban i nusukit* (adhurimit).

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

وَأَتِمُّوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ فَإِنْ أُخْصِرْتُمْ فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ الْهَدْيِ وَلَا تَحْلِقُوا رُءُوسَكُمْ حَتَّى يَبْلُغَ الْهَدْيُ مَحَلَّهُ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ بِهِ أَذًى مِنْ رَأْسِهِ فَفِدْيَةٌ مِنْ صِيَامٍ أَوْ صَدَقَةٍ أَوْ نُسُكٍ فَإِذَا أَمِنْتُمْ فَمَنْ تَمَتَّعَ بِالْعُمْرَةِ إِلَى الْحَجِّ فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ الْهَدْيِ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ فِي الْحَجِّ وَسَبْعَةٍ إِذَا رَجَعْتُمْ تِلْكَ عَشْرَةٌ كَامِلَةٌ ذَلِكَ لِمَنْ لَمْ يَكُنْ أَهْلُهُ حَاضِرِي الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ

“E kryeni haxhin dhe umren për hir të All-llahut, po në qoftë se pengoheni, atëherë (thëni për kurban) çka t'ju vijë më lehtë prej kurbaneve (dhuratë), e mos i rruani kokat tuaja derisa të arrijë kurban i (dhuratë) vendin e caktuar. Po cili prej jush është i sëmurë ose ka mundim koke (e rruhet para kohe) kompensimi është: agjërim, sadaka ose kurban (dhuratë). E kur jeni të sigurt, ai që bënë umren para haxhit (duhet therë) një kurban (dhuratë) që i vjen më lehtë, mirëpo nëse nuk ka, le të agjërojë tri ditë gjatë haxhit e shtatë ditë kur të ktheheni, këto janë dhjetë ditë të plota. Ky





është rregull për ata që nuk e kanë familjen pranë xhamisë së shenjtë (Qabes). Pra kini dro All-llahun dhe dijeni se All-llahu është ndëshkues i rreptë”.

(El-Bekare, 196)

Omeri r.a. ka thënë: “*Jepni dhuratë (kurban hedj), sepse Allahu e do dhuratën (kurbanin hedj)*”.

Edhe ky lloj kurbanin ndahet në dy lloje:

1. Kurbanin hedj vaxhib dhe
2. Kurbanin hedj nafile (vullnetar).


1. **Kurbanin hedj vaxhib** është kurbanin, të cilin e pret e haxhiu kur kryen haxhin Temetue dhe Kiranë, pa kryer ndonjë vepër të ndaluar gjatë mbajtjes së ihramit. Ndërsa, kurbanin hedj i demit (gjakut) është kurbanin vaxhib për shkak të moskryerjes së ndonjë vaxhibit të haxhit, ose për shkak të kryerjes së ndonjë veprimi të ndaluar.

Siç po shihet, kurbanin *hedj vaxhib* është për shumë arsye, e ato janë:

- për shkak të kryerjes së haxhit Temetue ose Kiran,
- për shkak të moskryerjes së ndonjë vaxhibi dhe
- për shkak të veprimit të ndalesave të caktuara.

Kurbanin hedj është tri llojesh: Deve, lopë dhe bagëti.

2. **Kurbanin hedj nafile** (vullnetar) quhet kurbanin, të cilën e ther njeriu (haxhiu) vetëm për t’iu afruar Allahut pa e pasur vaxhib. Ky lloj kurbanin është i parapëlqyer (mustehab) për atë, i cili ka vendosur të shkojë në haxh (Ifrad) ose në umre jashtë muajit të haxhit, pra dëshiron të dhurojë prej vetes së tij ndonjë kurban. Kjo





argumentohet me veprimin e të Dërguari të Allahut s.a.v.s., i cili ka dhuruar njëqind deve kurban.

TË USHQYERIT NGA KURBANI HEDJ (DHURATË)

Nëse kurban i hedj është për shkak të haxhit Temetuë ose Kiran, ose vullnetar, lejohet të ushqehet haxhiu prej mishit të atij kurban.

Nëse kurban i hedj është për shkak të Ihsarit, gjakut, përбетimit ose kefareteve (dënimeve) të haxhit, nuk lejohet të ushqehet nga ai kurban, sepse është vërtetuar se Pejgamberi s.a.v.s. kur ka qenë i penguar ta kryejë haxhin, në vitin e Hudejbijes, ia ka dërguar kurbanet Nexhijete Eslemijut dhe i ka thënë: ***“Ti dhe bashkudhëtarët e tu të mos hani asgjë nga mishi i kurbanit hedj”.***

KOHA E PRERJES SË HEDJIT (DHURATË)

Kurban Hedj i haxhit Temetuë dhe Kiran nuk lejohet të prehet në kohë tjetër, pos prej *pas faljes së Bajramit e deri në namazin e akshamit të ditës së tretë të Kurban Bajramit.*

Kurban Hedj vullnetar (nafile) lejohet të prehet një ditë para kurban Bajramit.

Kurban hedj i llojeve tjera si të kefareteve, nedhrit, i gjakut, etj. lejohen të prehen në çdo kohë, pra përpos tri ditëve të Kurban Bajramit, lejohen në çdo ditë tjetër të vitit, edhe pse më së miri është që të theret gjatë tri ditëve të Kurban Bajramit.





VENDI I THERJES SË HEDJIT (DHURATË)

Prerja e kurbanit hedj me llojet e tij vendin e ka vetëm në Meke, Muzdelife dhe Mine, ndërsa në asnjë vend tjetër nuk lejohet të prehet, sepse hedj do të thotë të dhuruarit në vend të posaçëm, e ai vend është Mekeja.

Transmeton Xhabiri r.a. se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Mina konsiderohet vend për therje të kurbanit hedj, Muzdelifeja konsiderohet vend për therje të kurbanit hedj dhe çdo kënd i Mekes konsiderohet vend për therje të kurbanit hedj”.

(Ebu Davudi dhe Ibni Maxhe)



Hedji Nedhr është atëherë kur ndokush përbetohet se *do të presë kurban e do t'i ushqejë të varfërit* ose përbetohet se *do të presë kurban*, me fjalë tjera i premtun Allahut bindshëm se *do të presë kurban dhe do t'i ushqejë të varfërit*.

NË CILAT RASTE PRITET KURBANI HEDJ

Kurbani Hedj pritet në për këto raste:

- Nëse haxhiu kontakton seksualisht para qëndrimit në Arafat, haxhi i prishet, por përpos kësaj ai duhet të therë një dele kurban, e pastaj e kryen haxhin kaza në vitin tjetër.
- Nëse haxhiu e kryen *tavafin thelbësor* xhunub ose femra me menstruacion, ose në kohën e lehonisë.
- Nëse haxhiu e kryen haxhin Kiranë dhe e kryen ndonjë gabim prej gabimeve të haxhit që obligon therjen e kurbanit, ai i ther dy kurbane, sepse haxhi i tij nuk është as Ifrad, as Temetuë, por Kiranë.





P.sh. nëse rruhet apo i shkurton flokët para therjes së kurbanit, ai një kurban e pret për shkak të vonimit të vaxhibit dhe një tjetër për shkak se është në haxhin Kiranë. Pra, dënimi me një kurban Hedj për shkak të vonimit.

- Veshja e rrobave, mbulimi i kokës, prerja e thonjve dhe të parfumuarit.

- Nëse shkurton një të katërtën e flokëve e më shumë ose një të katërtën e mjekrës e më shumë ther një dele kurban.

- Nëse në të njëjtën kohë i shkurton thonjtë e njërës këmbë ose të njërës dorë e therë një dele kurban.

- Nëse haxhiu parfumohet një pjesë të plotë të trupit, f.v. të parfumuarit e tërë kokës, gojës, këmbës, ose e pjesës më të madhe të trupit, e ther një dele kurban.

- Nëse haxhiu e vesh rrobën e parfumuar një ditë të plotë.

- Nëse e ngjyros kokën, mjekrën apo duart me kanë, e ther një dele kurban.

Nëse haxhiu shkurton flokët për shkak të ndonjë sëmundjeje në kokë ose parfumohet për shkak të një domosdoshmërie ose vesh rroba për shkak të domosdoshmërisë ai ka të drejtë të zgjedh në mes të kurbanit, ushqimit të gjashtë të varfërve ose agjërimin e tri ditëve. Kjo argumentohet me ajetin kur'anor:

... فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ بِهِ أَذًى مِنْ رَأْسِهِ فَفِدْيَةٌ مِنْ صِيَامٍ أَوْ صَدَقَةٍ أَوْ

نُسُكٍ ...

“Dhe kush është i sëmurë ose ka dhembje në kokë e rruhet (apo i shkurton flokët), për atë shkak ai duhet të kompensojë me agjërim, sadaka ose kurban”.

(El-Bekare, 196)

Po ashtu kemi hadithin e Muhamedit s.a.v.s., kur i thotë Keab bin Uxhres:





“A po të dhemb koka? Ai thotë – po. Muhamedi s.a.v.s. i thotë: “Shkurtoji flokët, dhe, ose preje një kurban, ose agjëro tri ditë, ose ushqeji një grup prej gjashtë personave të varfër”.

Analogji me këtë janë edhe çështjet tjera, si: të parfumuarit, veshja e rrobave dhe shkurtimi i thonjve.

Kontaktimi seksual

- Nëse përqafton, e puth apo e ledhaton bashkëshorten gjatë haxhit, ose ejakulon me dorë, vaxhib e ka haxhiu të pres kurban.

- Nëse kontakton seksualisht para qëndrimit në Arafat, haxhi priset, por në të njëjtën kohë e ka vaxhib të presë një dele kurban hedj dhe duhet vitin tjetër ta bëjë haxhin kaza.

- Nëse kontakton seksualisht haxhiu pas qëndrimit në Arafat dhe para se të rruhet apo para tavafit, e ka vaxhib që ta presë një lopë apo një deve kurban hedj. Nëse kontakton për të dytën herë, atëherë e ka vaxhib edhe një dele kurban hedj.

- Nëse kontakton pas qëndrimit në Arafat dhe pasi të rruhet apo t'i shkurtojë flokët, haxhiu e pret një dele kurban hedj.

Nëse gjatë tavafit të umres, para rrotullimit të katërt, haxhiu kontakton seksualisht me bashkëshorten, e pret një dele kurban dhe i zhvleftësohet umreja dhe e bën kaza një umre tjetër, ndërsa nëse pas katër rrotullimeve kontakton seksualisht me bashkëshorten dhe para shkurtimit të flokëve, e pret një dele kurban hedj.





PRERJA E KURBANIT HEDJ PËR SHKAK TË LËNIES SË NDONJË VAXHIBI

- Nëse e bën *tavafin përshëndetës* xhunub, vaxhib e ka haxhiu të pretë një dele kurban hedj.
- Nëse e bën *tavafin thelbësor* pa abdes, haxhiu e pret një dele kurban hedj, sepse ky tavaf është rukn i haxhit.
- Nëse e bën *tavafin thelbësor* xhunub, haxhiu pret një lopë ose një deve kurban hedj, sepse ky tavaf është thelbësor dhe dënimi është më i rëndë. Por, më së miri është që përderisa është në Meke ta përsëritë tavafin dhe të mos pretë kurban.
- Nëse *tavafin lamtumirës* e bën xhunub, haxhiu e pret një dele kurban.
- Nëse në vend të shtatë rrotullimeve të tavafit thelbësor haxhiu i bën vetëm katër dhe nuk i bën tre tjerët në vazhdim, haxhiu e pret një dele kurban hedj.
- Nëse në vend të shtatë rrotullimeve të tavafit lamtumirës haxhiu i bën tre rrotullime dhe nuk i bën katër rrotullimet tjera në vazhdim, haxhiu e pret një dele kurban hedj.
- Në të gjitha rastet që u përmendën, nëse haxhiu e përsërit tavafin, nuk prehet kurban i hedj, që do të thotë se nuk dënohet me kurban hedj, sepse e plotëson më përsëritje.





- Kush e bën tavafin me një të katërtën e organit të turpshëm të zbuluar, e përsërit tavafin, e nëse këtë nuk e bën, atëherë vaxhib e ka të presë një dele kurban.
- Kush nuk e bën ecjen prej Safa në Merve, pra Saëjin, vaxhib e ka të pretë një dele kurban hedj.
- Kush largohet nga Arafati, pra para përëndimit të diellit, lirohet nga dënimi i prerjes së kurbanit hedj.
- Kush nuk qëndron në Muzdelife, e ka vaxhib prerjen e kurbanit hedj.
- Kush nuk i gjuan tri ditë guralecët, e ka vaxhib prerjen e kurbanit hedj.
- Kush një ditë nuk i gjuan guralecët, e ka vaxhib kurbanin hedj.
- Kush nuk i gjuan guralecët në njërin prej xhemerateve, vaxhib e ka prerjen e kurbanit hedj.
- Kush nuk i gjuan guralecët në ditën e parë pas qëndrimit në Muzdelife, e ka vaxhib prerjen e kurbanit hedj.
- Kush i shkurton flokët apo rruhet pas tri ditëve të Kurban Bajramit, e ka vaxhib prerjen e kurbanit hedj.
- Kush e bën tavafin thelbësor pas tri ditëve të Kurban Bajramit, vaxhib e ka prerjen e kurbanit hedj.
- Kurhani hedj prehet për haxhin temetuë dhe kiran, ashtu siç kemi përmendur më parë.
- Nëse haxhiu vendos ta kryejë haxhin kiran, ai për çdo gabim pret dy kurbane hedj si dënim: një për haxhin e tij dhe një për umren e tij. Përpos, nëse e tejkalon kufirin e Mikatit të Ihramit, atëherë ai e pret vetëm një dele kurban.
- Në të gjitha rastet e prerjes së kurbanit mishi shpërndalet në tërësi, e jo në proporcion një me tre.





3. KURBANI I NEDHRIT (PËRBETIMIT)

Para se të shpjegojmë kurbanin Nedhr (të përбетimit) të sqarojmë vetëm “Nedhrin” – përбетimin, sipas sheriatit islam.

Nedhr do të thotë obligimi apo ngarkimi i vetvetes për t’iu afruar (kurb) Allahut me një çështje me të cilën nuk je i obliguar.

Zoti i Lartmadhëruar tregon për rastin e Merjemes:

... فَإِذَا تَرَيْنَ مِنَ الْبَشَرِ أَحَدًا فَقُولِي إِنِّي نَذَرْتُ لِلرَّحْمَنِ صَوْمًا فَلَنْ أُكَلِّمَ
الْيَوْمَ إِنْسِيًّا

“Dhe nëse të sheh ndonjë njeri thuaj: Vërtet unë jam përбетuar në të Gjithëmëshirshmin në një lloj agjërimi, e ai është se nuk do të flas me asnjë njeri”.

(Merjem, 26)

Të heshturit, të mosfolurit ka qenë lloj adhurimi i Merjemes, e ai adhurim është të siguruarit e gjuhës nga të folurit.

DISPOZITA E PËRBETIMIT (NEDHRIT)

Përбетimi është prej çështjeve të lejuara (mubah).

Argument për këtë kemi ajetin kur’anor:

وَمَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ نَفَقَةٍ أَوْ نَذَرْتُمْ مِنْ نَذْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُهُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ





“Dhe çfarëdo shpenzimi që shpenzoni (për Allahun) apo përbetoheni se do ta kryeni ndonjë premtim, nuk ka dyshim se Allahu atë e di”.

(El-Bekare, 270)

Argument nga hadithi:

Transmeton Buhariu nga Aishja r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Kush përbetohet se do ta kryejë një veprim, i cili është adhurim ndaj Allahut, le ta kryejë atë përbetim. E kush përbetohet se do ta bëjë ndonjë mëkat, atë përbetim mos ta kryejë”.

Përbetimi është i lejuar, mirëpo pas përbetimit kryerja e përbetimit është vaxhib, nëse është për afrim tek Allahu.

Përbetimi mund të jetë:

1. Përbetim pa kurrfarë shkaku (mutlak).
2. Përbetim me ndonjë kusht apo arsye (mukajid).

Përbetimi pa kurrfarë shkaku (mutlak) është përbetimi si p.sh.:

“Për Zotin do të agjërojë këtë ditë”;

“Betohem në Zotin se do të jap këtë sadaka”;

“Betohem në Zotin se do t'i fali dy rekate nafile namaz”;

“Betohem në Zotin se do ta pres një kurban”.


Përbetimi me ndonjë kusht apo arsye (mukajid)


Përbetimi me kusht është kur njeriu përbetohet: *“Nëse Zoti ma plotëson këtë dëshirë (si f.v. të punësohem, të ndërtoj shtëpi, ta kryej këtë punë etj.) përbetohem se do ta pres një kurban”.*

Edhe pse ky lloj përbetimi është mekruh, prapëseprapë kryerja e këtij përbetimi është i obligueshëm (vaxhib).

Pra mund të vijmë në përfundim se njeriu:

- përbetohet se do ta presë një kurban pa treguar asnjë shkak;



- 
- 
-
- përbetohet se do ta presë një kurban, duke kushtëzuar me realizimin e ndonjë dëshire (të lejuar) të tij.

Që në të dy rastet, therja e kurbanit quhet Kurban i Nedhrit (përbetimit), e i cili është vaxhib.

KOHA E THERJES SË KURBANIT NEDHR (TË PËRBETIMIT)

Sikurse edhe te kurban i Ud-hije ashtu edhe te kurban i Nedhrit, koha e therjes është prej faljes së Bajramit e deri në aksham të ditës së tretë të Kurban Bajramit.

SHPËRNDARJA E KURBANIT NEDHR

Shpërndarja e mishit të këtij kurban i nuk bëhet sikurse te kurban i Ud-hije (i sakrificës), por patjetër duhet të shpërndahet i tërë mishi. Pra, nuk shpërndahet në tri pjesë: një për familje, një për farefisnin dhe një për të varfrit.



4. KURBANI AKIKË (I MBUROJES)

Kurbani Akikë quhet kurban i cili thërritet me rastin e lindjes së fëmijës. Transmetohet nga Ibni Abasi se Muhamedi s.a.v.s. i ka prerë dy dele kurbanë akikë për Hasanin dhe Huseinin” Pra, për secilin prej tyre nga një dash.

Urtësia e prerjes së këtij kurban i është falënderimi ndaj Allahut, i cili na ka dhuruar fëmijë, që fëmija të rritet, të zhvillohet si është më së miri, që fëmija të bëhet i ndershëm, fisnik, i dobishëm dhe i devotshëm, dhe po ashtu të gëzuarit e familjarëve dhe shokëve me ushqim dhe duke i ndërlidhur zemrat në mes vete.

Nëse njeriut i lindin binjak, i pret dy kurbanë *akikë*. Kjo do të thotë se nuk lejohet një kurban për binjak, por dy dele për binjak. E nëse i ka shtatë fëmijë, ai mund ta presë një lopë ose një deve për shtatë fëmijë.

Koha e prerjes së këtij lloji të kurbanit është dita e shtatë prej ditës së lindjes së fëmijës.

Kur të prehet akiki thuhet: *“O Zoti im, prej Teje dhe për Ty po e pres këtë kurban akikë për filanin”*. Sepse Bejhekiu në hadithin me isnadin (zinxhirin) e mirë ka regjistruar hadithin se Ajshja r.a. ka thënë:

“Pejgamberi a.s. ka prerë akikë për Hasanin dhe Husejnin dhe ka thënë: ‘Thoni kur ta preni akikin: “Bismilahi, o Zoti ynë prej Tej dhe për Ty akiki ,i cili prehet për filanin”.





Dallimi në mes të kurbanit *akikë* dhe kurbanit ud-hije është se kurbanit *akikë*, pasi të prehet, është sunet të gatuhet dhe përgatitet dhe ashtu i përgatitur u jepet të tjerëve, sepse Fatimja r.a. kështu ka vepruar, pasi që e kishte urdhëruar Pejgamberi s.a.v.s. (Këtë e ka transmetuar Bejhekiu). Edhe pse lejohet të jepet sadaka edhe pa u përgatitur, ne vetëm jemi duke treguar se çfarë është më së miri.

KOHA E PRERJES SË KËTIJ KURBANI

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَالْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا
وَحَيْرٌ أَمَلًا

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë”.

Në ajet tjetër thotë:

(لِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ يَهَبُ لِمَنْ يَشَاءُ إِنَاثًا وَيَهَبُ
لِمَنْ يَشَاءُ الذُّكُورَ (49) أَوْ يُزَوِّجُهُمْ ذُكْرَانًا وَإِنَاثًا وَيَجْعَلُ مَنْ يَشَاءُ عَقِيمًا إِنَّهُ
عَلِيمٌ قَدِيرٌ (50))

“Vetëm i All-llahut është pushteti i qiejve e i tokës; Ai krijon çka të dojë; Ai i dhuron vetëm femra atij që do; e i dhuron vetëm meshkuj atij që do. Ose u dhuron çift, meshkuj e femra, por atë që do e lë pa fëmijë (steril); Ai është i dijshtëm, i fuqishëm”.

Kur muslimanit i dhurohet një fëmijë, në ditën e shtatë të lindjes së atij fëmije i shkurtohen flokët, i maten në kandar (që





shërben për matjen e arit) dhe në peshë të atyre flokëve vlerësohet çmimi në ar, dhe në atë shumë jepet sadaka. Pastaj i thirret ezani në veshin e djathtë, ikamiet i veshin e majtë, emërtohet (pagëzohet) dhe theret kurbanin. Nëse kjo, pra therja e kurbanit nuk bëhet, respektivisht në ditën e shtatë të lindjes, atëherë theret edhe më vonë, por edhe pasi të kalojnë edhe shumë vite prej kohës kur ka lindur fëmija.

MËNYRA E PËRGATITJES SË AKIKIT

Kurbani *akik* nuk shpërndahet, siç është rasti me llojet e kurbaneve të tjerë, dhe pasi të theret nuk copëtohet, kështu që pasi t'i hiqet lëkura, ose zihet i tëri, ose piqet i tëri në hell, dhe pa ia prerë apo pa ia thyer eshtrat fare, ofrohet për ushqim. Ndërsa eshtrat e kurbanit vetëm se shkëputen apo shpërndahen gjatë ushqimit. Kjo është mënyra, e cila parapëlqehet më së shumti, megjithëse lejohet të pritët, të copëtohet dhe të shpërndahet.





5. KURBANI VASIJET I TË VDEKURIT

Kurbani është vaxhib, i cili ndryshon nga sadakatul fitri. Te sadakatul fitri prindi jep sadakanë edhe për fëmijët për të cilët është përgjegjës, gjë që kjo nuk është kështu te kurban, por prindi e ther një kurban për tërë familjen, pra qëllimin dhe nijetin e bën për vete. Po ashtu burri nuk ther kurban, me fjalë tjera, nuk e ka vaxhib të therë kurban për gruan e vet, por nëse gruaja posedon pasuri të pavarur, ajo e ka vaxhib të presë kurban prej pasurisë së vet të pavarur. Po ashtu nuk është vaxhib kurban të theret për prindërit e vdekur, por nëse prehet, kurban pranohet si sadaka, dhe ky kurban nuk e liron assesi djalin nga vaxhibi e që ai të mos presë për vete, por djali duhet të pres në rend të parë kurbanin për vete, ta kryejë vaxhibin, e pastaj edhe të dytin për prindin e vdekur të tij. Kështu veprohet nëse prindi i vdekur nuk e ka lënë vasijet (porosi). Por, nëse prindi e ka lënë vasijet (porosi) para vdekjes së tij, që t'i theret një kurban, kryerja e vasijetit është vaxhib dhe ai kurban duhet të theret për të.

KOHA E PRERJES SË KURBANIT TË VASIJETIT

Kurbani i vasijeti, sikurse kurban i ud-hije (i sakrificës) theret prej faljes së Kurban Bajramit e deri në aksham të ditë së





Kurban Bajramit. E jo ashtu siç thuhet se për të vdekurin prehet natën, pra një ditë para ditës së Kurban Bajramit, e për të gjallin ditën e Kurban Bajramit”.

SHPËRNDARJA E KURBANIT TË VASIJETIT

Kurbani për të gjallin është e pëlqyer të ndahet në tri pjesë: një pjesë ndahet për vete, një pjesë familjes së afërt dhe një pjesë të varfërve. Ndërsa sa i përket kurbanit për të vdekurin vaxhib, pra është e detyrueshme që i tëri të shpërndahet, e jo të ndahet në tri pjesë.





Përfundim

Këto ishin pesë llojet e kurbanit të cilat janë të argumentuara me Kur'an dhe Sunet të Pejagamberit s.a.v.s.. Ne e kemi treguar se kurbanit është ibadet, që do të thotë se sakrifikimi i kafshës, derdhja e gjakut dhe shpërndarja e mishit janë pjesë e ibadeti, ashtu siç është ibadet namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi, si dhe format tjera të ibadetit. Për këtë edhe themi se ibadeti është adhurim, e ibadeti duhet të argumentohet. Përpos këtyre llojeve të kurbanit është bërë traditë në të kaluarën, por po praktikohet edhe në ditët e sotme që dikush e pret një kurban me rastin e gurthemelit të shtëpisë, me rastin e gurthemelit të ndonjë ure, me rastin e gurthemelit të ndonjë shkolle, me rastin e gurthemelit të ndonjë ambulate, të ndonjë punëtorie, ashtu që gjaku i kurbanit të therur të derdhet në themel. Mirëpo, kjo formë e prerjes së kurbanit nuk ka argument dhe nuk është e ligjësuar në shariatin Islam. Pra, kjo nuk lejohet.

Po ashtu dikush ther kurban me rastin e hyrjes në banesë të re, apo të fillimit të punës për të ecur puna mbarë. Edhe kjo nuk është e ligjësuar dhe nuk ka argument për këso rastesh. Duhet bërë dallimin në mes të kurbanit (sakrifikimit) dhe prerjes së kafshës. Këtë dallim mund ta ilustrojmë me rastin e gostisë së martesës. Kur ftohen miqtë, dashamirët, shokët e të afërmit, mirë është të prehet një dele dhe të gostiten, por prerja e deles nuk quhet kurban, por gosti e rëndomtë. Gjaku i tillë, i cili derdhet, nuk është gjak kurbanit (flijimi-sakrificë), mish i asaj dele nuk quhet mish kurbanit, por mish i rëndomtë, i cili u jepet





apo u ofrohet dashamirëve me rastin e gostisë së martesës. Sepse kur është martuar njëri prej shokëve të Muhamedit s.a.v.s. Muhamedi a.s. ka thënë:

“ Organizo gosti, there së paku (dhe përgatit ushqim) një dele.”

Prerja e kësaj dele, për këso raste nuk lejohet dhe as që quhet kurban, por vetëm gosti.

Kështu pra, mund të vijmë në përfundim se prerja e kurbanit në rastet e sipërpërmendura nuk është e ligjësuar, ndërsa nëse pritet dele dhe përgatitet gosti për mjeshtrit, për familjarët, kjo është diçka tjetër, jo kurban i cilësuar ibadet, por vetëm mish i rëndomtë. Pra këtu është dallimi.

Lusim Zotin e Lartmadhëruar që të na mundësojë ta kuptojmë të vërtetën dhe të veprojmë me të, e ta kuptojmë të pavërtetën e të mos punojmë me të.

SUBAHNE RABIKE
RABIL IZETI AMA JESIFUN
VE SELAMUN ALEL MURSELINE
VEL-HAMDULILAH RABILALEMINE






LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”.
21. “Kurbani i Ud'hijes, Hedjit, Nedhrit, Akikit dhe i Vasijetit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim);
2. “Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi);
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrezak Nufel);
4. “Për Kushtetutën Islame” (nga autori Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer);
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. “Vlera e kohës” (nga autori Amër Halid);







7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid);
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid);
9. “Pendimi” (nga autori Amër Halid);
10. “Pasojat e mëkateve” (nga autori Amër Halid);
11. “Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
12. “Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
13. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët
Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir).

PËRMBAJTJA:

KURBANI	3
IBRAHIMI A.S. DHE KURBANI I XHENETIT	7
KUSHTET E THERJES SË KURBANIT	10
KUSHTET QË DUHET T’I PLOTËSOJË KAFSHA PËR KURBAN	13
ÇKA LEJOHET TË PREHET PËR KURBAN	14
KAFSHA QË NUK LEJOHET TË PREHET KURBAN	14
KAFSHA E CILA ËSHTË MEKRUH TË PREHET KURBAN	15
DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR KURBANIN	16
PËR SA PERSONA PREHET KURBANI	16
KOHA E THERJES SË KURBANIT	17
SHPËRNDARJA E MISHIT TË KURBANIT	17
KUSH DUHET TA REALIZOJË PRERJEN E KURBANIT	18
PARA PRERJES SË KURBANIT	19
SI DUHET VEPRUAR ME RASTIN E PRERJES SË KURBANIT	19
MJEKËSIA PËR THERJEN E BAGËTIVE	21
Ç’NDODH KUR PRERJA BËHET ME DËMTIM TË SHTYLLËS KURRIZORE?	24
LLOJET E KURBANIT	25
1. KURBANI UD-HIJE (I SAKRIFICËS)	25
2. KURBANI HEDJI (I DHURATËS)	27
TË USHQYERIT NGA KURBANI HEDJ (DHURATË)	29
KOHA E PRERJES SË HEDJIT (DHURATË)	29
VENDI I THERJES SË HEDJIT (DHURATË)	30
NË CILAT RASTE PRITET KURBANI HEDJ	30
PRERJA E KURBANIT HEDJ PËR SHKAK TË LËNIES SË NDONJË VAXHIBI	33
3. KURBANI I NEDHRIT (PËRBETIMIT)	35
DISPOZITA E PËRBETIMIT (NEDHRIT)	35
KOHA E THERJES SË KURBANIT NEDHR (TË PËRBETIMIT)	37
SHPËRNDARJA E KURBANIT NEDHR	37





4. KURBANI AKIKË (I MBUROJES)	38
KOHA E PRERJES SË KËTIJ KURBANI	39
MËNYRA E PËRGATITJES SË AKIKIT	40
5. KURBANI VASIJET I TË VDEKURIT	41
KOHA E PRERJES SË KURBANIT TË VASIJETIT	41
SHPËRNDARJA E KURBANIT TË VASIJETIT	42
PËRFUNDIM	43
LIBRAT E AUTORIT	45

